



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0287
Data e Vendimit: 06.05.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “PRO MEDICAL” SH.P.K. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë” me numër prokurimi 624-25-2455-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SUHAREKË”, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 06.05.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jashteafatshme, ankesa e OE “PRO MEDICAL” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0287, e datës 23.04.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë” me numër prokurimi 624-25-2455-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - “KOMUNA SUHAREKË”, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- “KOMUNA SUHAREKË” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 23/04/2024, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 2025/0287 nga OE “PRO MEDICAL” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë”, me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1, inicuar “KOMUNA SUHAREKË” në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 01.04.2025 “KOMUNA SUHAREKË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë, ku sipas këtij njoftimi Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qen data: 23.04.2025.

OE “PRO MEDICAL” SH.P.K. me 18.04.2025 OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 22.04.2025 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si te pa bazuar.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë” me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1, inicuar nga “KOMUNA SUHAREKË”, njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 01/04/2025, Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qen data: 23/04/2025. Ndërsa me datë 18/04/2025 OE “PRO MEDICAL” SH.P.K. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 22/04/2025 e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 12.03.2025 është parashtruar jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik.

-Përfundim-

Neni 108/A paragrafi 3.3 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “..3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”.

Autoriteti kontraktues - “KOMUNA SUHAREKË”, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë” me numër prokurimi 624-25-2455-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtijvendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: